



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Intrast" Sh.P.K. të datës 06.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Ndriçimi për sinjalizues për vendkalime për siguri" me nr. të prokurimit 616-23-4210-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Intrast" Sh.P.K. e datës 06.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Ndriçimi për sinjalizues për vendkalime për siguri" me nr. të prokurimit 616-23-4210-5-1-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 30.11.2023 i autoritetit kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Intrast" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Intrast" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 06.12.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Ndriçimi për sinjalizues për vendkalime për siguri" me nr. të prokurimit 616-23-4210-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: “Ne vendim thuhet se nuk i kemi dorezuar mostrat siq jane kerkuar ne dosje te tenderit per pozicionet: 34, 35, 40, 41, dhe 69. Me date 04.12.2023 kemi kerkuar qasje ne dokumentacionin tenderik. Qasja na eshte mundesuar po ne te njejten dite ne ora 11: 15. Gjate qasjes se bashku me zyrtaren e prokurimit kemi shkuar dhe e kemi pa vendndodhjen e mostrave. Komisioni i vleresimit ka menduar se ne e kemi sjellur vetem nje moster te semaforit, sepse nuk e kane pare edhe nje pako tjeter me pajisjet tjera, pasi qe ishte e mbuluar me disa mostra te kompanive tjera. Kete se bashku me zyrtaren e prokurimit e konstatuam se pakoja me mostra gjendent ne zyret e prokurimit ne Komunen e Prishtines. Kerkojme nga AK, qe lenda te kthehet ne rivleresim, pasi qe vendimi per eliminim per mos dorezimin e mostrave nuk qendron”.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit përmes zyrtarit bartës të aktivitetit të prokurimit si dhe anëtarëve të komisionit vlerësues ka konfirmuar se parashtruesi i ka sjellur mostrat të cilat gabimisht është konstatuar se nuk i ka sjellur. Pra mostrat janë sjellur mirëpo nuk janë shqyrtuar fare nga komisioni vlerësues. Natyrisht se ky veprim është në kundërshtim të plotë me nenin 59 të LPP dhe nenin 40 të RRPP. Në këtë mënyrë është konfirmuar se pretendimet ankimore janë të bazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj është vendosur që kërkesa për rishqyrtim të miratohet si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 11.12.2023

Visar SHEHU
UD. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.